

URDHËR
Nr. 124, datë 23.3.2022

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË
MJEDISËT E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, të shkronjës “b”, nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në qarkun Durrës, Dibër dhe Korçë.
 2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në qarkun Durrës, Dibër dhe Korçë.
 3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë, vetëm për në thertore në qarkun Durrës, Dibër dhe Korçë me dokumentacionin e parashikuar sipas legjislacionit në fuqi.
 4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I
BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Ermira Gjeçi